



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 1334 Prot 8

Vlorë, më: 30 . 10 2023

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI 4

Datë: 18.10.2023 Ora: 16:30

Tema: Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.11769 datë 4.10.2023.

Marrin pjesë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak- znj.Elpinqi Mërkuri, Kryetari i Rajonit 4- Donald Leskaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, këshilltarë të bashkisë, Drejtori i buxhetit dhe financës-Hiqmet Haxhaj, sektori i tatim taksave. drejtorë të administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media,

(Ne takim moren pjese me shume se 34 persona, listeprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Përshendetje, të gjithëve! Jemi mbledhur për buxhetin. Ky është takimi i fundit, me 5 rajonet dhe 4 njësite administrative, për të diskutuar mbi planifikimin e buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe projektbuxhetin e vitit 2024 per Bashkinë Vlorë.

Rajoni 4 ka patur probleme. Janë planifikuar disa investime në buxhet si dhe projekte nga qeveria. Është prezent drejtori i financës, drejtoresha e ujit, drejtori i urbanistikës të cilët do ju kthejnë përgjigje dhe sqarojnë më mirë.



Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024

Per me shume klikoni

<https://fb.watch/nM-9bOTGMj/?mibextid=v7YzmG>

Hiqmet Haxhiaj: Vimë këtu për të marrë vendimin tuaj në lidhje me planifikimin e buxhetit afatmesem 2024-2026 dhe draft buxhetin e vitit 2024. Treguesit bazë për buxhetin afatmesëm 2024-2026. Për vitin 2024 të ardhurat totale 2 miliard ...lek

Shpenzimet kryesore janë për:

Administratën publike, zjarrfikësen, ujitja dhe kullimi, shpenzime investimi rreth 376 milion...

Për rajonin 4 në buxhetin e vitit 2024 është paarshikuar:

- Rikonstruksion i shkollës 15 Tetori
- Rikonstruksion i rrjetit tercial të ujrave të zeza
- Ndricimi, përmirësimi I lulishteve
- Nga Fondi i Zhvillimit kemi projekte të vecanta.

Klaudio Mehmetaj- Përvec rikonstruksionit të shkollës 15 Tetori kemi dhe bllokun e banesave rreth zonës së shkollës; Sistemi i kanalizimeve të rajonit 4; ndërhyrje te tregu ne Lagjen 24 Maj; pallatet pas shkollës Jani Minga do rikonstruktohen. Në shkollën Ibrahim Kushta dhe shkollën Shaban Demiraj do ndërhyhet për të përmirësuar godinat.

Banor: Jam nga Skrapari por kam 20 vjet që banoj këtu. Paguaj taksat për pastrimin, ndricimin, gjelbërimin dhe nuk kemi shërbim. Kanali i hapur përpara shtëpisë time. Vendosen llampa pjesë pjesë. Te ura e Zogës është pa pastruar. Punoni!

al Dredha: Kam ardhur t'ju dëgjoj, cfarë mund të përmirësojmë. Do punojmë së prandaj kam ur!



Banor: 1-Te hidrovari, kam bërë këkesë disa herë

2-Pastrimi i pyllit. Mirëmbajtje ose përdorim kam bërë kërkese.

3-Taksat. Kam 11 vjet që i paguaj. Jam i kënaqur nga ujësjellësi dhe elektriku. Nuk kam asnje vrrejtje për këto institucione. Por ka dhe gjëra që nuk shkojnë.

Janë zënë hapsirat publike. Duhet të paguajnë dy herë më shumë taksa kur zënë hapsira publike.

Nasif Aliaj-Banor: Banoj në lagjen 24 Maj. Kam këto probleme:

Rruga nga Bejkosala, është e pa kaueshme, Ajdeni shikojeni.

Kanali ka probleme.

Mbeturinat kanë një muaj pa u hequr. Kishim tre kazanë dhe na i morën.

Banor: Banoj te shkolla Jani Minga. Kemi 2 muaj që kemi bërë kërkese për te hequr bolierët se po na bie soleta. Midis pallateve është një kënd i pakalueshëm, sillni skrepin të lirohet rruga se është bërë pengesë.

Klaudio Mehmeti: Na dergoni vendndodhjen dhe do vijmë ta shikojmë.

Banor: Kanali kur do mbulohet? Të pastrohet të paktën. Ndricim nuk kemi. Trotuar jo. Pastrim nuk ka.

Ermal Dredha: Zambak merru me kërkese e qytetarit.

Elentina-Banore dhe mbikqyrëse e pastrimit: Banorët i vënë flakën mbetjeve. Është e rrezikshme mbledhjen duke u djegur. E kontrollojmë situatën por komuniteti duhet të mbaj pastër. Është përgjegje e ulët.

Banor: Ndërgjegjësimi është i pari. Pylli po humbet. Prihen pemët. Cfarë do bëhet. Firmat dhe fasoneritë i hedhin mbeturinat në pyll. Pastrohet dhe mbushet prapë nga fasoneritë. Lagja ka qënë e qepur por ka filluar të pastrohet.

Banor: Rrugët e lagjeve i kemi me bagëti. Fshatarët i kanë sjellë me vete kafshët. Pastrimi është bërë por duhet bërë kujdes.

Ermal Dredha: Kemi aplikuar gjoba. Duhet ndërgjegjësim dhe nga ana e komunitetit.

Banor: Kemi shqetësim pastrimin dhe vendosjen e koshave si dhe ndricimin.

Ermal dredha: Po blejme kosha.

Banor: Je djalë Vlore. Tregu duhet të rregullohet.

Banor: Ne pensionistët duam një vend për të kaluar kohën, lulishtet s'ka, pensionistët janë braktisur, jemi rrugëve, as linja autobusi nuk ka. Të zgjaten oraret e autobusave se mbyllen ne oren 16..

Elona Hodaj: është projekti, I kemi dhënë zgjidhje.

Banor: Kryetari i rajonit e di problemin tim

1. Rruga ku banoj ka 24 familje. 100 m rrugë ska as kanalizime. Të bëhen.
2. Uji vjen më shumë fatura e energjisë sesa kemi ujë në shtëpi. Jemi me pompa individuale cdo familje.

Elona Hodaj: Bëni marrëveshje me njëri tjetrin dhe vendosni një pompë të përbashkët, për të ulur kostot e fatures së energjisë.

Klaudio Mehmeti: duhet edhe pjesa nëntokësore, jo vetëm asfalti. Do bëhet projekti nga Fondi.

Ermal Dredha: Faleminderit!

Konceptoi: Albana Naçi

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

